



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM

Nr. 18, datë 19.04.2019

PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES “PROCEDURA E ANKIMIT NË KOMISIONIN
KOMBËTAR RREGULLATOR TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA, PËR NJË TË
LICENCUAR”

Në mbështetje të nenit 13, pika (1) i) të nenit 14, neni 28, neni 29 dhe neni 30 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” i ndryshuar (*ligji nr. 8102*); Ligj nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (*ligji nr. 44/2015*), neni 9 e vijues i Rregullore së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura (*Rregullore e Brendshme*)

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 19.04.2019 pasi shqyrtoi çështjen në rend dite Miratimi përfundimtar i projekt aktit administrativ Rregullore “Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar” sipas dokumentacionit të paraqitur:

1. Projekt akti Rregullore “Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar” (*Projekt akti*)
2. Relacioni mbi projekt aktin Rregullore “Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar” (*Relacioni*)
3. Projekt akti administrativ vendimmarrës për miratimin e projekt aktit (*Projektvendimi*),

Vëren se:

1. Projekt akti nxirret nga KKRR në mbështetje të kompetencës ligjore të parashikuar në pikën (1) i të nenit 14 të ligjit nr. 8102 sipas të cilit KKRR për të përmbushur mandatin e tij sipas këtij ligji, ka kompetentë të nxjerri rregulla për të ndihmuar ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të parashikuara në këtë ligj.

Nxjerrja e projekt aktit bazohet edhe në kompetencën e ERRU të përcaktuar në nenin 29 të ligjit nr. 8102 sipas të cilit ERRU miraton rregullat procedurale që, do të përdorë për kryerjen e funksioneve që i jep ky ligj. Këto rregulla përmbajnë:

...(ii) skedimin e aplikimeve, ankesave dhe kërkesave të tjera që i janë dorëzuar komisionit....

2. Në nenin 30 të ligjit nr. 8102 lidhur me ankesat përcaktohet e drejta e çdo personi të interesuar për t'i dërguar Komisionit një ankesë me shkrim për një të licensuar, për të cilin mendon se ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 8102, apo të ndonjë urdhëri, rregulli, license apo udhëzimi të nxjerrë sipas këtij ligji. Gjithashtu, në këtë dispozitë ligjore përcaktohet detyrimi i Komisionit për të njoftuar menjëherë të licensuarin me anë të një njoftimi me shkrim për ankesën dhe t'i lerë atij mundësinë për t'iu përgjigjur me shkrim. Si dhe, procedura e ankimit bëhet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Kjo nënkupton që procedura që duhet të zbatohet nga palët, ankimesi si person i interesuar dhe Komisioni si organi administrativ që mbart detyrimin ligjor të shqyrtimit të ankesës, si dhe i licencuari si subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa, duhet të bazohet në përcaktimet e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative si ligj i përgjithshëm.

3. Kodi i Procedurave Administrative në fuqi në Republikën e Shqipërisë është ligji nr. 44/2015. Procedura administrative për paraqitjen e ankesës në Komision dhe shqyrtimin e ankesës nga Komisioni bazohet tërësisht në ligjin nr. 44/2015.

4. Qëllimi i këtij projekt akti është vendosja e një kuadri rregullator për zbatimin e së drejtës që ka çdo person i interesuar për t'i dërguar Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura që udhëheq Entin Rregullator të Ujit (ERRU), një ankesë me shkrim për një të licensuar, për të cilin mendon se ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" të ndryshuar apo të ndonjë urdhëri, rregulli, license apo udhëzimi të nxjerrë sipas këtij ligji.

Objektivi kryesor i projekt aktit është informimi i cilësdo palë të interesuar, që në mënyrë transparente, të njohë dhe zbatojë procedurën që do të zbatohet nga organi administrativ kompetent, për ushtrimin e një të drejte themelore siç është e drejta e ankimit.

5. Në nenin 29 të ligjit 8102, pika (1) b) përcaktohet që rregullat procedurale që nxjerr ERRU për kryerjen e funksioneve që jep ky ligj të përmbajnë mundësinë për koment publik, duke

përfshirë edhe komentet nga ana e Këshillit të Ministrave. Ky përcaktim gjeti zbatim nëpërmjet publikimit të projekt aktit administrativ për këshillim publik në faqen zyrtare të ERRU-së www.erru.al nga data 04.03.2019 deri më datë 04.04.2019.

Për sa më sipër duke qenë në kushtet e plotësimit të kërkesave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 8102 për nxjerrjen e Projektaktit, si dhe të përputhshmërisë së plotë të përmbajtjes së tij me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 44/2015,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullore “Procedura e ankimit në Komisionin Kombëtar Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, për një të licencuar”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit për zbatimin e kësaj rregullore dhe njoftimin e shoqërive ujësjellës kanalizime për miratimin e kësaj rregullore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

Ndriçim Shani **Kryetar**

Lindita Molla **Zëvendëskryetare**

Silvana Simaku **Anëtare**